

**UNITED
NATIONS**

United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES

Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Ligjislatura e dytë

*Komisioni për Shëndetësi, Punë
dhe Mirëqenie Sociale
Nr. 28/2007*

PROCESVE BAL

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të mbajtur më 1. 10. 2007, në sallën N-225, në orën 13.00

Të pranishëm: Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, kryetare: Shpresa Murati, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Fehmi Vula, Zylfije Hundozi, Nurishahe Hulaj dhe Ferid Agani ,

Morën pjesë

z. Dugagjin Zaberxha nga Ministria e Shëndetësisë

Mbledhjen e drejtoi **Fatmire Mulhaxha – Kollçaku** dhe propozoi këtë:

REND DITE

- 1 Miratimi i procesverbalin të mbledhjes se kaluar ,**
- 2 Shqyrtimi i Projektligjit për barnat narkotike ,substancat psikotrope dhe prekursorët.**
- 3 Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuar**
- 4 Të ndryshme**

Rendi i ditës u miratua.

U hap shqyrtimi për pikën e parë

1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar ,

Pasi nuk u dha vërejtje u miratua.

U hap shqyrtimi për pikën e dytë

2. Shqyrtimi i Projektligjit për barnat narkotike ,substancat psikotrope . dhe prekursorë

Fatmire Mulhaxha –Kollçaku, përshëndeti përfaqësuesin e Ministrisë se Shëndetësisë dhe ftoi z.Aganiin që të raportojë lidhur me Projektligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë .

Z. Ferid Agani vërejtjet ua ofroi anëtarëve në formë tabelore duke i dhënë komentet për çdo amendamenti. Kontribut dhanë në formulimin e amendamenteve deputetët : Shpresa Murati, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Fehmi Vula, Nurishahe Hulaj , Zylfije Hundozi dhe Nafije Berisha

Dukagjin Zaberxha nga Ministria e Shëndetësisë dhe ne cilësi të hartuesit të projektligjit nënvizoi se Projektligji i ofruar duhet të harmonizohet me rregulloren e BE e qe ka të bëjë me prekursor .Ai propozoi të shlyhet tabela nr. 4 e cila rregullon klasifikimet e bimëve ,barnave narkotike substancave,prekursorëve dhe përgatesave të tyre . Ajo kërkoi që i behet serish një rishikim para se të miratojë Projektligjin . Komisioni e miratoi propozimin dhe vendosi që në mbledhjen e 2.10.2007 serish të shqyrtojë dhe amendanetet me raport të . Ne amendamentin 45 pati vërejtje dhe Komisioni vendosi të fshijë

U hap shqyrtimi për pikën e tretë

3 Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuar

Flora Brovina në cilësi të raportueses lidhur me Projektligjin nënvizoi se në zbatimin e tij ka vështirësi në mungesë të Ligjit të punës, ligjit për pensione, ligjin për sigurime shëndetësore dhe ajo kërkoi që këtij t'i behet amendamentimit ne titullin

Kryetarja i propozoi Komisionit të shtyhet kjo pikë pasi shumica e anëtareve nuk i ka marrë amendamentet nga z. Flora Brovina dhe duke u bazuar se më 2.10.2007 do ta prezantojë përfaqësuesi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale si dhe z. Halit Ferizi nga hendikosi .

Me propozimin e saj të pranishmit u pajtuan dhe lidhur me këtë pikë u nxor ky :

P e r f u n d i m

Më 2.10.2007 Komisioni do të këtë shqyrtimin e Projektligjit për rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuar

U hap shqyrtimi për pikën e katërt

4 Të ndryshme

Kryetarja vuri ne pah numrin e projektligjeve të papërfunduara dhe shtoi se Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin të skemës sociale ka mbetur pa u caktuar raportuesi .

Komisioni lidhur me këtë pikë nxori këtë :

P e r f u n d i m

Komisioni e ngarkon znj. Nafije Berisha të përgatisë raportin bashkë me sugjerimet e dhëna nga OSEB-ja lidhur me Projektligjin për plotësimet dhe ndryshimet për skemën ndihmës sociale

Mbledhja përfundoi në orën 14.30

Procesmbajtës,

Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

**Kryetarja e Komisionit
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**